Nr.11243-02092-00-2010 i Regj.Themeltar
Nr.00-2014-2499 i Vendimit (362)

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Ardian Dvorani	Kryesues
Evelina Qirjako	Anëtare
Tom Ndreca	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Edmond Islamaj	Anëtar

në seancën gjyqësore të datës 06.06.2014, mori në shqyrtim çështjen civile nr.11243-02092-00-2010, që i përket:

KËRKUES:	SC ENERGY HOLDING SRL
PALË E TRETË:	KESH

OBJEKTI:
Njohja e vendimit përfundimtar date 18.02.2010
të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit.
Baza Ligjore: Nenet 393, 395, 396 te K.Pr.Civile

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.55, datë 23.06.2010 ka vendosur:

Njohjen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Gjenevës Zvicër të datës 18.02.2010 me palë Shoqërinë S.C. Energy Holding S.R.L.kundër K.E.SH.sha.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, në bazë të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit, e cila kërkon prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes po në Gjykatë të Apelit Tiranë për rigjykim,

Duke parashtruar këto shkaqe:

- Ne si Avokaturë e Shtetit duhet të ishim thërritur në gjykim si " Person i Tretë " gjë që nuk është bërë.
- Formimi i ndërgjyqësisë është i gabuar pasi KESH është vendosur si palë e interesuar ku një term i tillë nuk gjendet në Kodin e Procedurës, në një kohë që duhet të ishte vendosur si palë e paditur.
- Fletëthirrja e datës 16.06.2010 e Gjykatës së Apelit Tiranë është njoftuar pranë institucionit tonë pa ndonjë akt tjetër bashkangjitur saj. Është më se e qartë se në këtë rast Gjykata e Apelit gjykon si gjykatë e shkallës së parë dhe rrjedhimisht duhet të respektojë të gjitha parimet e garancitë procedurale që i takojnë një gjykimi në një

shkallë të tillë duke na vënë në dispozicion kërkesën për njohjen e vendimit. Në këtë mënyrë do të respektohej neni 156 i K.Pr.Civile.

- Në seancën e datës 23.06.2010 i kemi kërkuar gjykatës kohë për tu njohur me kërkesën e paraqitur dhe për të patur një kopje të provave dhe dokumentave të dorëzuara në dosje por nga ana e saj u rrëzua kërkesa jonë.
- Kërkesa e jonë drejtuar Gjykatës së Apelit (e cila u rrëzua me vendim të ndërmjetëm) për njohje me kërkesën e paraqitur në Gjykatë për njohje vendimi dhe me provat e paraqitura nga kërkuesi do të na mundësonte pikërisht të njihnim kërkesat e palës tjetër dhe më pas të paraqisnim mbrojtjen tonë lidhur me respektimin e kërkesave të nenit 396 të K.Pr.Civile.
- Dëshirojmë të sjellim në vëmendjen e Gjykatës së Lartë se po kjo gjykatë në një çështje të ngjashme (*çështja me kërkues Iliria shpk me objekt njohje dhe dhënie fuqi ligjore vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit të datës 13.07.1993, vendim nr.1067, datë 26.09.2007 i Gjykatës së Lartë*) ka arsyetuar mjaftë qartë se Gjykata e Apelit gjykon si gjykatë e shkallës së parë dhe se duhet të respektojë të gjitha dispozitat procedurale që gjejnë zbatim gjatë gjykimit në një shkallë të tillë.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoi relatorin e çështjes Edmond Islamaj, përfaqësuesin e palës kërkuese av. Grhard Velaj që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe Avokatin e Shtetit që kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes në atë gjykatë me një tjetër trup gjykues, dhe pasi analizoi dhe diskutoi çështjen në tërësi;

V Ë R E N

Se vendimi nr.503, datë 21.05.2010 i Gjykatës së Apelit Vlorë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural civil e si i tillë duhet të prishet.

A. Rrethanat e çështjes

Pala kërkuese, S.C.Energy Holding SRL është një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Rumun. Midis palëve ndërgjyqëse është lidhur një kontratë me nr.Ref.01.06/AJ-Ost, "Për blerje të energjisë elektrike për periudhën 01.07.2006 deri 31.12.2006 ", e nënshkruar me datë 02.06.2006.

Pala kërkuese, sipas kontratës, merrte përsipër t'i lëvronte energji palës së interesuar nga korriku 2006 deri në muajin dhjetor 2006, ku periudhat e lëvrimit ishin të ndara në dy "lote", Loti II dhe Loti III ku secili mbulonte lëvrimin për një periudhë 3 mujore.

Kontrata parashikonte detyrimet e furnizimit të kërkuesit (paditësit) duhet të siguroheshin nga dy garanci përmbushjeje, një për secilin Lot, për t'u hapur me një shumë prej 10 % të vlerës së Lotit përkatës. Detyrimi i palës se interesuar (e paditur) për pagesë duhet të sigurohej nga garanci pagese mujore.

Mosmarrëveshja e lindur midis palëve është se Kërkuesi (paditësi) pretendon se, nga ana e personit të interesuar (i paditur) nuk është hapur garancia e pagesës mujore sipas kushteve të kontratës, duke qenë me shkelje të kontratës gjatë periudhës që lëvrohej Loti III. Detyrimi i personit të interesuar (i paditur) për të patur një Garanci Pagese ishte kusht paraprak që kërkuesi, (paditësi) të përmbushte detyrimin e lëvrimit. Shkelja e një detyrimi të tillë e shkarkon atë nga detyrimi i lëvrimit. Ai kishte të drejtë të reduktonte sasinë e energjisë

që do të lëvrohej. Meqenëse kërkuesi (paditësi) nuk shkeli kontratën kërkimi i garancisë së përmbushjes për Lotin III nga ana e personit të interesuar (padituri) ishte i pajustifikuar.

Pala e interesuar (e paditur) ka pretenduar se nuk e lëvroi sasinë e energjisë së kërkuar, kërkimi i garancisë për Lotin e III ishte i justifikuar.

Kërkuesi padinë kundër Korporatës Elektroenegjitike Shqiptare (KESH) (e paditur) e ngriti në Gjykatën e Arbitrazhit UNCITRAL, Gjenevë (Zvicër).

Gjykata e Arbitrazhit UNCITRAL, Gjenevë (Zvicër) me date 16.02.1010 mori këtë vendim:

1. DEKLARON se, kërkesa për pagesë nga i padituri Korporata Energjitike Shqiptare (KESH sha) për Garancinë e Përmbushjes nr.S 8116258, lëshuar nga ALPHA Banke Romania SA Uniri Branch, me datë 27 Qershor 2006 ishte e pajustifikuar dhe në kundërshtim me kushtet e Kontratës nr.Ref.01-06/AJ-Ost.

2. DEKLARON se, i padituri Korporata Energjitike Shqiptare (KESH sha) i detyrohet Paditësit S.C.Erengy Holding S.R.L. një shumë prej 933 984 Euro plus interesin në një shkalle prej 9 % duke filluar që nga data 19 Janar 2007 e deri në datën e pagesës dhe URDHËRON të Padituri Korporata Energjitike Shqiptare (KESH sha) që të paguajë këtë shumë dëmshpërblimi dhe interesat pas shpalljes së këtij vendimi.

3. DEKLARON se, i padituri Korporata Energjitike Shqiptare (KESH sha) i detyrohet Paditësit S.C. Energy Holding S.R.L. për kostot dhe shpenzimet ligjore, përfshirë kostot e Arbitrazhit, në një shumë prej 441.677,63 Euro plus interesin në shkallën prej 9 % që rrjedhin prej njoftimit të këtij Vendimi e deri në datën e pagesës dhe URDHËRON te Padituri Korporata Energjitike Shqiptare (KESH sha) qe t'i paguaje Paditësit S.C.Energy Holding S.R.L këtë shumë kostosh dhe interesi pas shpalljes së këtij vendimi.

4. RRËZON pa mundësi ankimi çdo e të gjitha ankesat, kërkesat dhe korigjimet e kërkuara nga i padituri Korporata Energjitike Shqiptare (KESH sha)

5. RRËZON pa mundësi ankimi të gjitha ose të tjera ankesa të secilës palë.

Duke qene se vendimi i Gjykatës së Arbitrazhit është përfundimtar dhe i formës së prerë, pala paditëse S.C.Energy Holding S.R.L. i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë për njohjen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të datës 16.02.2010.

B. Procedurat Gjyqësore

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.55, datë 23.06.2010 ka vendosur:

Njohjen e vendimit përfundimtar të Gjykatës Ndërkombëtare të Arbitrazhit të Gjenevës Zvicër të datës 18.02.2010 me palë Shoqërinë S.C. Energy Holding S.R.L.kundër K.E.SH.sha

C. Arsyetimi i vendimeve të gjykatave.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.55, datë 23.06.2010 ka arsyetuar ndër të tjera se:

"...Gjykimi i kësaj gjykate rezulton të jetë bërë në prezencë të palës paditur KESH sh.a. Vendimi i mësipërm i Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar është përfundimtar dhe i formës së prerë. Kopja e vendimit është e shoqëruar me apostil dhe është përkthyer në gjuhën shqipe dhe legalizuar.

Si përfundim nuk rezulton që vendimi i gjykatës së huaj të jetë në kundërshtim me parimet bazë të legjislacionit shqiptar.

Sa me sipër, Gjykata e Apelit Tiranë, konkludon se kërkesa e kërkuesit Shoqërisë S.C Energy Holding S.R.L, duhet të pranohet, pasi është e bazuar në ligj dhe në prova."

D. Në lidhje me ankimin (rekursin).

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, në bazë të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka ushtruar rekurs Avokatura e Shtetit, e cila kërkon prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes po në Gjykatë të Apelit Tiranë për rigjykim,

Duke parashtruar këto shkaqe;

Ne si Avokaturë e Shtetit duhet të ishim thërritur në gjykim si " Person i Tretë " gjë që nuk është bërë.

Formimi i ndërgjyqësisë është i gabuar pasi KESH është vendosur si palë e interesuar ku një term i tillë nuk gjendet në Kodin e Procedurës, në një kohë që duhet të ishte vendosur si palë e paditur.

Fletëthirrja e datës 16.06.2010 e Gjykatës së Apelit Tiranë është njoftuar pranë institucionit tonë pa ndonjë akt tjetër bashkangjitur saj. Është më se e qartë se në këtë rast Gjykata e Apelit gjykon si gjykatë e shkallës së parë dhe rrjedhimisht duhet të respektojë të gjitha parimet e garancitë procedurale që i takojnë një gjykimi në një shkallë të tillë duke na vënë në dispozicion kërkesën për njohjen e vendimit. Në këtë mënyrë do të respektohej neni 156 i K.Pr.Civile.

Në seancën e datës 23.06.2010 i kemi kërkuar gjykatës kohë për tu njohur me kërkesën e paraqitur dhe për të patur një kopje të provave dhe dokumentave të dorëzuara në dosje por nga ana e saj u rrëzua kërkesa jonë.

Kërkesa e jonë drejtuar Gjykatës së Apelit (e cila u rrëzua me vendim të ndërmjetëm) për njohje me kërkesën e paraqitur në Gjykatë për njohje vendimi dhe me provat e paraqitura nga kërkuesi do të na mundësonte pikërisht të njihnim kërkesat e palës tjetër dhe më pas të paraqisnim mbrojtjen tonë lidhur me respektimin e kërkesave të nenit 396 të K.Pr.Civile.
Dëshirojmë të sjellim në vëmendjen e Gjykatës së Lartë se po kjo gjykatë në një çështje të ngjashme (*çështja me kërkues Iliria shpk me objekt njohje dhe dhënie fuqi ligjore vendimit të Gjykatës së Arbitrazhit të datës 13.07.1993, vendim nr.1067, datë 26.09.2007 i Gjykatës së Lartë*) ka arsyetuar mjaftë qartë se Gjykata e Apelit gjykon si gjykatë e shkallës së parë dhe se duhet të respektojë të gjitha dispozitat procedurale që gjejnë zbatim gjatë gjykimit në një shkallë të tillë.

E. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, konstaton se pretendimet e parashtruara në rekursin e paraqitur nga Avokatura e Shtetit, përbëjnë shkaqe ligjore në kuptim të Nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile që të motivojnë cënimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kolegji civil i Gjykatës së Lartë e gjen të drejtë pretendimin e Avokaturës së Shtetit në lidhje me faktin se vendimi i gjykatës së Apelit Tiranë është marrë në kundërshtim me nenin 4 të Konventës së Nju Jorkut, si dhe me vendimin Unifikues nr.6, datë 01.06.2011 të Gjykatës së Lartë i cili përcakton se:

"... Gjykata e Apelit duhet *të verifikojë dhe, eventualisht, të kryejë të gjitha veprimet që i parashikon ligji procedural civil, Konventa e Nju Jorkut, ligji i posaçëm ose marrëveshja tjetër ndërkombëtare e zbatueshme (nëse ka të tillë), për të garantuar, edhe kryesisht, thirrjen në gjykim së të gjitha palëve debitore që rezultojnë nga përmbajtja e vendimit të gjykatës së huaj ose gjykatës së huaj të arbitrazhit që kërkohet t'i jepet fuqi nga ajo gjykatë e apelit.*

Në shqyrtimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo të gjykatës së huaj të arbitrazhit, gjykata e apelit zbaton rregullat e gjykimit të shkallës së parë.

Mes të tjerave, sikurse vepron gjykata e shkallës së parë, me paraqitjen e kërkesëpadisë apo edhe nëpërmjet kryerjes së veprimeve përgatitore, gjykata e apelit paraprakisht verifikon përmbushjen e kushteve dhe kritereve formale të paraqitjes së kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj ose të gjykatës së huaj të arbitrazhit. Posaçërisht, gjykata e apelit verifikon nëse kërkesa, sipas rastit, plotëson kushtet paraprake formale të parashikuara nga neni 395 e 396 i Kodit të Procedurës Civile, neni 4 i Konventës së Nju Jorkut apo që përmbahen në ligje të tjera të posaçme ose akte të së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme për çështjen në gjykim.

Nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj ose të gjykatës së huaj të arbitrazhit ka mangësi dhe të meta, gjykata e apelit i cakton kërkuesit një afat të arsyeshëm për plotësimin dhe ndreqjen e tyre. Gjykata e apelit kthen kërkesën dhe aktet e tjera pa veprim, nëse pala kërkuese, brenda afatit që i është caktuar, nuk plotëson dhe ndreq mangësitë dhe të metat formale të kërkesës.

Nëse kërkesa për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo të gjykatës së huaj të arbitrazhit përmbush kushtet për rregullshmërinë formale-procedurale të paraqitjes së saj, gjykata e apelit cakton seancën gjyqësore në të cilën objekti i gjykimit është vetëm ekzistenca ose jo e ndonjërës prej ndalimeve a pengesave ligjore të parashikuara nga neni 394 i Kodit të Procedurës Civile, neni 5 i Konventës së Nju Jorkut apo nga ndonjë dispozitë tjetër e posaçme për këtë qëllim, e parashikuar nga ligji ose një marrëveshjeje ndërkombëtare. Në përfundim të gjykimit, gjykata e apelit vendos për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për dhënien fuqi të vendimit të gjykatës së huaj apo gjykatës së arbitrazhit të huaj. ..."

Nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë nuk është verifikuar rregullshmëria formale e kërkesës, duke marrë të mirëqenë ekzistencën e marrëveshjes thjesht duke u nisur nga përmbajtja e vendimit të arbitrazhit.

Kërkesa e kërkuesit për njohjen e vendimit në fjalë nuk është shoqëruar me kopjen e marrëveshjes ku parashikohet zgjidhja e mosmarrëveshjeve nëpërmjet arbitrazhit dhe përkthimin zyrtar të saj.

Mos kryerja e kësaj procedure të fazës së parë të gjykimit ka bërë që praktikisht gjykata e apelit të ishte në pamundësi për të shqyrtuar dhe analizuar ekzistencën e ndonjë pengese ligjore të parashikuar në nenin 394 të Kodit të Procedurës Civile.

Për sa më sipër ky vendim do të prishet, duke i lënë për detyrë Gjykatës së Apelit Tiranë të zbatojë përcaktimet e vendimit unifikues nr.6, datë 01.06. 2011 të Gjykatës së Lartë si dhe nenin 4 të Konventës së Nju Jorkut dhe 394 të Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 485/c të Kodit të Procedurës Civile,

V E N D O S I

Prishjen e vendimit nr.nr.55, datë 23.06.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me një tjetër trup gjykues.

Tiranë, më 06.06.2014